

Nr. 753 Prot
28.08.2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANATI

Nr. 126 prot.

Tiranë, më 27/08 2020

Lënda : Dërgohet plani i detajuar i organizimit të mbylljes së procesit mësimor për vitin e parë dhe të dytë bachelor dhe vitin e parë master për vitin akademik 2019-2020 për periudhën 31.08.2020 deri 31.10.2020.

Drejtuar: Rektorit të Universitetit të Arteve
Prof. Kastriot ÇAUSHI

I nderuar zoti Rektor!

Departamentet e Fakultetit të Artit Skenik, pasi u njohën me urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 104, datë 30.4.2020 për "Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19", si dhe të vendimit të rektoratit të UARIT me nr.34 datë 04 Maj 2020, "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Universitetin e Arteve", ndermorën masat konkrete që do të realizohen për detajimin e procesit që duam të realizojmë në vazhdimësi për përmbylljen e vitit akademik 2019-2020.

Për këtë qëllim Dekanati i Fakultetit të Artit Skenik në datë 05.05.2020 mori vendimin me nr 75 "Për Marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, në Fakultetin e Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve".

Në këtë material që po paraqesim po pasqyrojmë edhe kërkesat tona për strukturat administrative të UARIT në dobi të ruajtjes së distancimit social si dhe pastërtisë dhe higjienizimit të ambjenteve. Një gjë duhet ta bëjmë të qartë : **ne si fakultet nuk zoterojmë struktura dhe mundësi financiare për të zbatuar saktë dhe ashtu sic duhet protokollin e sigurisë për këtë pandemi që ka rënë.** Nga ana tjetër ne po bëjmë gjithë përpjekjet e duhura dhe po marrim masat konkrete për planifikimin e procesit mesimor, provimet e mbartura si dhe sezonin e provimeve e mbrojtjen e diplomave seminareve për studentët e vitit të parë dhe të dytë Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të studimeve Master. Gjithmonë duke parë mundësinë e dhënies së provimeve në lëndët speciale në mënyrë individuale dhe me grupe të vogla.

Ne kërkojmë nga administrata e UART një zbatim të rreptë për protokollin e sigurisë si rezultat i pandemisë Covid 19. Të njëjtën gjë do kërkojmë edhe nga punonjësit e fakultetit tonë.

Për hyrje daljet në UART dhe më pas në fakultetin tonë, kërkojmë të hapet vetëm një derë dhe personat që do të marrin pjesë në procesin mesimor të jenë nën kontroll të vazhdueshëm, pasi kurrsesi nuk duhet lejuar të hyjnë persona të tjerë në ambjentet tona. Dera e cila ndodhet në fakultetin tonë dhe që deri në kohën kur u ndërmor masa e ndalimit të procesit mesimor për shkak të pandemisë Covid 19 ka qenë e hapur, ne nuk do të lejojmë të hapet perseri. Një pakujdesi e tillë mund të ketë pasoja në shëndetin e studenteve dhe pedagogëve.

Ne e kemi shqetësim mungesën e sigurisë në ambjentet tona pasi në UART hyn kushdo madje edhe me mjete motorike. Kjo vihet re menjëherë dhe përbën një shqetësim serioz.

Gjithashtu ne garantojmë një kordinim dhe përfshirje të gjithë personelit administrativ të fakultetit për këtë qëllim.

Për këtë arsye do të mendonim se duhet treguar kujdesi i duhur nga ana e administratës së UART për;

- Dezinfektant duarsh përpara ambjenteve ku zhvillohet mesim,
- Maska për studentet,
- Sapun larje duarsh ,
- Dezinfektim tualetesh dhe klasave periodikisht gjatë ditës,
- Në hyrje të fakultetit si dhe të klasave dhe auditoreve ku do të zhvillohet mesim të afishohen rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

FAS realizoj ditët e fundit konkursin e pranimeve dhe nuk u mor asnjë masë për të bërë dezinfektimin e ambjenteve, edhe pse ne paraqitëm edhe kërkesë me shkrim e nuk morëm asnjë përgjigje.

Planifikimi i realizimit të procesit mësimor konform udhëzimeve përkatëse për të realizuar me sukses mbylljen e vitit akademik 2019-2020, periudhë që do të realizohen përsëritjet, konsultimet, seminarët, praktikat, provimet e mbartura si dhe sezoni i provimeve për studentët e vitit të parë dhe të dytë në Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të studimeve në master Master sipas këtij kalendari të poshtëshënuar:

- a) 31 Gusht-2 Tetor, realizimi i përsëritjeve të lëndëve të specialitetit për secilin program studimi, leksioneve, seminarëve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve Master.*
- b) 21 Shtator-2 Tetor, zhvillimi i provimeve të mbartura, si dhe përgatitja për provimet përfundimtare.*
- c) 3 Tetor-25 Tetor, sezoni i provimeve.*

d) *26 Tetor-31Tetor, Sezoni i provimeve të vjeshtës, si dhe përmbyllja e dokumentacionit.*

VITI I- II-TË BACHELOR DHE VITI I I-TË MASTER

- Mësimi do të zhvillohet nga data *31 Gusht-2 Tetor 2020.*
- Provimet e mbartura do të realizohen nga data *21 Shtator-2 Tetor 2020.*
- Provimet do të realizohen nga data *3 Tetor-25 Tetor.*
- Sezoni i provimeve të vjeshtës do të realizohet nga data *26 Tetor-31Tetor.*
- **Koncepti i realizimit të programit mësimor, të konsultimeve, seminareve, të provimeve të mbartura dhe të provimeve, do të mbështetet nga një mirë-organizim dhe planifikim i këtij procesi prej udhëheqësve të kurseve të secilit program studimi. Në bazë të këtij plani të paraqitur nga secili udhëheqës i kursit pranë departamentit përkatës, do të veprohet.**
- **Do të shfrytëzohen edhe hapësirat në studio, apo atelie që janë krijuar nga mbyllja e provimeve të diplomave të bachelorit dhe të masterit.**
- **Mbi gjithshka do të jetë ruajtja e distancimit fizik, në të gjitha lëndët që do të realizohen në fakultetin tonë.**
- Mësimi do të bëhet me distancim fizik në klasa, atelie, studio e salla, si dhe on-line.
- Lendet që janë detyrim do të përfundojnë me vleresim në javën e fundit të procesit, duke i marre studentet individualisht.
- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamentet.
- Proçesi i praktikave profesionale do të realizohen njëherësh me projektet artistike.
- Realizimi i të gjitha provimeve të lëndëve artistike profesionale do të realizohet në varësi të secilit program studimi, pra në specifikat e tyre ato do të realizohen në grupe të vegjël dy, tre student duke u mbështetur në masat që kërkon protokollin shëndetësor në rastin e Covid 19. Në ndonjë rast mundet edhe në skenë, nëse grupi është deri në 4 studente, gjithmone duke ruajtur distancimin social.

VITI I-rë dhe i II-të BACHELOR

Programi i studimit AKTRIM

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

- **LËNDËT SPECIALE ARTISTIKE**

- Këto lëndë do të organizohen në procesin e konsultimeve në grupe të vogla 1 deri në 2 studentë, të ndarë në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë duke ruajtur rigorozisht distancimin social.

Shënim:

- *Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve i cili do të miratohet nga shefi i departamentit, gjithmonë duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.*

Programi i studimit REGJI

- Lendët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.
- LËNDËT SPECIALE ARTISTIKE.
- Këto lëndë do të organizohen në procesin e konsultimeve në grupe të vogla të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë duke ruajtur rigorozisht distancimin social.

Shënim:

- *Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve i cili do të miratohet nga shefi i departamentit, gjithmonë duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.*

Programi i studimit REGJI FILMI DHE TV

- Lendët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

LËNDËT SPECIALE ARTISTIKE

- Këto lëndë do të organizohen në procesin e konsultimeve në grupe të vogla të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë duke ruajtur rigorozisht distancimin social.

Shënim:

- *Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve i cili do të miratohet nga shefi i departamentit, gjithmonë duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.*

PROGRAMI I STUDIMIT SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI

- Lendët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e përcaktuar nga departamenti.
- **LËNDA SPECIALE ARTISTIKE PIKTURË**
- Kjo lëndë do të organizohet në procesin e konsultimeve në grupe të vogla deri 5 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë duke ruajtur rigorozisht distancimin social.
-Vendi i zhvillimit konsultimeve do të jetë atelieri i skenografise me siperfaqe mbi 120 m².
- **LËNDA SPECIALE ARTISTIKE SKENOGRAFI**
- Kjo lëndë do të organizohet në procesin e konsultimeve sipas programit mësimor në grupe të vogla deri 5 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë.
- Lënda Praktikë profesionale është detyrim dhe do të mbrohet nga studentet ditën e fundit të procesit mësimor apo konsultimeve, duke ruajtur rigorozisht distancimin social
-Vendi i zhvillimit konsultimeve do te jete atelieri i skenografise me siperfaqe mbi 120 m².

LËNDA SPECIALE ARTISTIKE KOSTUMOGRAFI

- Kjo lëndë do të organizohet në procesin e konsultimeve në grupe të vogla deri 5 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë.
- Lënda Praktikë profesionale është detyrim dhe do të mbrohet nga studentet ditën e fundit të procesit mësimor apo konsultimeve, duke ruajtur rigorozisht distancimin social
-Vendi i zhvillimit konsultimeve do te jete atelieri i skenografise me siperfaqe mbi 120 m².

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

PROGRAMI I STUDIMIT KOREOGRAFI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

LËNDË SPECIALE ARTISTIKE

Ky program studimi ka në dispozicion dy salla si dhe palestrën, të cilat i përmbushin mundësitë e hapësirave të distancimit social.

- Lëndë speciale të koreografisë do të organizohet në procesin e konsultimeve mbështetur në programin mësimor në grupe të vogla 2-4 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë dhe të dytë.
- Lënda Praktikë profesionale është detyrim dhe do të mbrohet nga studentet ditën e fundit të procesit mësimor apo konsultimeve, duke ruajtur rigorozisht distancimin social
- Lëndët:-Teknika te Produksionit Skenik, -Praktikë Profesionale, -Repertor, -Danc Klasik, -dhe Teknika Xhazi, do të organizohen në procesin e konsultimeve në grupe të vogla të studentëve të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit përkatës.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid-19.

VITI I -rë MASTER

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NE AKTRIM E MESUESI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

Lënda speciale artistike:

- Lënda Aktrim do të organizohet sipas programit mësimor në procesin e konsultimeve në grupe të vogla 2-4 studentë të ndarë në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë master.
- Lënda Praktika Mesimore do zhvillohet në konsultim me pedagogët udhëheqës on-line me detyra dhe një projekt teorik përfundimtar.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NË REGJI TEATRI DHE SPEKTAKLI DHE MESUESI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

Lënda speciale artistike:

- Lënda Regji do të organizohet sipas programit mësimor në procesin e konsultimeve në grupe të vogla deri 3 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë master.
- Lënda Praktika Mësimore do zhvillohet në konsultim me pedagogët udhëheqës on-line me detyra dhe një projekt teorik përfundimtar.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NË REGJI FILMI DHE TV DHE MESUESI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

Lëndët speciale artistike:

Lënda artistike do të organizohet sipas programit mësimor në procesin e konsultimeve në grup deri 3 studentë sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë master.

- Lënda Praktika Mësimore do zhvillohet në konsultim me pedagogët udhëheqës on-line me detyra dhe një projekt teorik përfundimtar.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NE SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE MËSUESI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

Lënda speciale artistike:

- Lënda artistike do të organizohet sipas programit mësimor në procesin e konsultimeve në grup deri në 3 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të pare master.
- Lënda Praktika Mësimore do zhvillohet në konsultim me pedagogëtr udhëheqës on-line me detyra dhe një projekt teorik përfundimtar.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NË KOREOGRAFI DHE MËSUESI

- Lëndët teorike të cilat janë organizuar dhe zhvilluar online, do të realizojnë përsëritjen në formën on-line në ditët dhe orarin e percaktuar nga departamenti.

Lëndët speciale artistike:

Lënda speciale artistike do të organizohet sipas programit mësimor në procesin e konsultimeve në grupe të vogla deri 2-4 studentë të ndara në orare të njëpasnjëshme sipas organizimit dhe planifikimit të pedagogut të kursit të parë.

- Lënda Praktika Mësimore do zhvillohet në konsultim me pedagogëtr udhëheqës on-line me detyra dhe një projekt teorik përfundimtar.

Shënim:

Secili pedagog kursi do të paraqesë me përgjegjësi pranë departamentit organizimin dhe planifikimin e zhvillimit të procesit të konsultimeve dhe të realizimit të provimeve duke u mbështetur në rregullat bazë për mbrojtjen nga Covid 19.

Provimet teorike për të gjithë programet e studimit në të dy ciklet,do të organizohen në ambiente të përshtashme me gojë në mënyrë individuale për studentët.

Në mënyrë më të detajuar po paraqesim organizimin e provimeve të lëndëve speciale artistike

Programi i studimit AKTRIM

VITI I PARË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **10** (dhjete)
- Jane 7 lëndë speciale qe zhvillon viti i parë aktrim-bachelor.
- 5 lende janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Bazat e Mjeshtërisë së Aktorit do te zhvillohet në menyre individuale dhe me partner deri në tre student duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete salla e vogel do te jete studio nr.1 Aktrim me sip. 70 m². .
- **Lënda Teknika e të Folurit** per vete specifiken qe ka ky proces, dhe nga ana tjetër per kufizimet qe na vendosin rregullat strikte per Covid 19, do të organizohet në mënyrë individuale.

VITI I DYTË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **14** (katërmëdhjete)
- Jane 7 lende speciale qe zhvillon viti i dytë aktrim-bachelor.
- 5 lende janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Mjeshtri e Aktorit-DIALOGU, do te zhvillohet ne grup me 2 studentë.
- **Lënda Fjala Artistike** per vete specifiken qe ka ky proces, dhe nga ana tjetër per kufizimet qe na vendosin rregullat strikte per Covid 19, do të organizohet në mënyrë individuale.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete studio nr.2 Aktrim me sip. 70 m².

Programi i studimit REGJI

VITI I PARË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **9** (nëntë).
- Jane 6 lende qe zhvillon viti i parë regji-bachelor.
- 3 lënde janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Bazat e Regjisë do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe me partnerë deri në 3 studentë duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit studio nr.1 Regji me sip. 70 m².
- Provimi i lendes speciale Mjeshtëri e Aktorit do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe me partner deri në tre studentë duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit do të jetë studio nr.1 Regji me sip. 70 m².
- **Lënda Teknika e të Folurit** për vetë specifikën që ka ky proces, dhe nga ana tjetër për kufizimet që na vendosin rregullat strikte për Covid 19, do të organizohet në mënyrë individuale.

VITI I DYTË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **12** (dymbëdhjetë).
- Jane 5 lende qe zhvillon viti i dytë regji-bachelor.
- 2 lënde janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Regji-DIALOGU, do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe me partnerë deri në 3 studentë duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit studio nr.2 Regji me sip. 70 m².
- Provimi i lendes speciale Mjeshtëri e Aktorit do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe me partner deri në tre studentë duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit do të jetë studio nr.1 Regji me sip. 70 m².
- **Lënda Fjala Artistike** për vetë specifikën që ka ky proces, dhe nga ana tjetër për kufizimet që na vendosin rregullat strikte për Covid 19, do të organizohet në mënyrë individuale.

Programi i studimit REGJI FILMI DHE TV

VITI I PARË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **9** (nëntë).
- Jane 6 lende qe zhvillon viti i parë regji filmi dhe tv-bachelor.
- 4 lënde janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Bazat e Regjisë së Filmit do te zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Klasa e filmit nr.1 Regji me sip. rreth 40 m².
- Provimi i lendes speciale Regji TV do te zhvillohet ne menyre individuale po në të njëjtin ambient

VITI I DYTË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **14** (katërmbëdhjetë).
- Jane 7 lende qe zhvillon viti i dytë regji filmi dhe tv-bachelor.
- 4 lënde janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Regji e Filmit Dokumentar do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Klasa e filmit nr.2 Regji me sip. rreth 40 m².
- Provimi i lendes speciale Regji TV do te zhvillohet ne menyre individuale po në të njëjtin ambient.
- Lënda Aktori para Kameras do te zhvillohet ne menyre individuale po në të njëjtin ambient.

Programi i studimit SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI

VITI I PARË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte **10** (dhjetë).
- Jane 5 lende qe zhvillon viti i parë -bachelor.
- 2 lënde janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.

- Provimi i lendes speciale Skenografi do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².
- Provimi i lendes speciale Kostumografi do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².
- Provimi i lendes speciale Pikturë do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².

VITI I DYTË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte 16 (gjashtëmbëdhjetë).
- Jane 4 lende qe zhvillon viti i dytë -bachelor.
- 1 lëndë janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit te procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Skenografi do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².
- Provimi i lendes speciale Kostumografi do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit te provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².
- Provimi i lendes speciale Pikturë do të zhvillohet ne menyre individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².

Programi i studimit KOREOGRAFI

VITI I PARË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte 13 (trembëdhjetë).
- Jane 6 lende qe zhvillon viti i parë -bachelor.
- Janë 4 lëndë detyrim dhe do te mbrohen nga studentet ditën e fundit te procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi lendes speciale Bazat e Kompozimit në Danc do te zhvillohet ne menyre individuale dhe në grup deri në 2 studentë.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete salla e koreografise nr.1 me sipërfaqe 100 m².

VITI I DYTË BACHELOR

- Grupi i studenteve eshte 9 (nëntë).
- Jane 6 lende qe zhvillon viti i dytë -bachelor.
- Janë 4 lëndë detyrim dhe do te mbrohen nga studentet ditën e fundit te procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi lendes speciale Danc Permormancë do te zhvillohet ne menyre individuale dhe në grup deri në 2 studentë.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete salla e vogël e koreografise me siperfaqe 100 m².

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE MASTER

Programi i studimit: MASTERI ARTEVE NE AKTRIM E MESUESI

VITI I PARË

- Grupi i studenteve eshte 7 (shtate) studentë
- Jane 6 lëndë speciale qe zhvillon viti i parë aktrim-bachelor.
- 4 lende janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lendes speciale Aktrim per vete specifiken qe ka ky proces, dhe nga ana tjeter per kufizimet qe na vendosin rregullat strikte per Covid 19, eshte e veshtire te realizohet bazuar ne planin mesimor. Ajo mund te behet interpretim ne tavoline.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete studio nr.1 Aktrim me sip. 70 m².
- Lënda Dramaturgji do të zhvillohet si lëndet e tjera teorike dhe studentet do te merren ne provim individualisht me goje.
-Vendi i zhvillimit te provimit do te jete klasë në ambjentet e FAS.

Programi i studimit: MASTER I ARTEVE NE REGJI TEATRI DHE SPEKTAKLI DHE MESUESI

VITI I PARË

- Grupi i studenteve eshte 6 (gjashtë).
- Janë 4 lende qe zhvillon viti i pare master ne regji teatri dhe spektakli dhe mesuesi.

- 1 lende është detyrim dhe do të mbrohet individualisht nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lëndës speciale Regji do të zhvillohet në mënyrë individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit Salla Black-Box me sip. 120 meter katror
- Lënda Dramaturgjia do të zhvillohet si lëndet e tjera teorike dhe studentet do të merren në provim individualisht me gojë.
Vendi i zhvillimit të provimit do të jetë klasë në ambjentet e FAS.
- Lënda Bazat e Kritikës do të zhvillohet si lëndet e tjera teorike dhe studentet do të merren në provim individualisht me gojë.
Vendi i zhvillimit të provimit do të jetë klasë në ambjentet e FAS.

Programi i studimit: MASTER I ARTEVE NË REGJI FILMI DHE TV DHE MESUESI

VITI I PARË

- Grupi i studenteve është 3 (tre).
- Janë 6 lende që zhvillon viti i parë master në regji filmi dhe tv dhe mesuesi.
- 5 lende janë detyrim dhe do të mbrohen individualisht nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lëndës speciale Regji Filmi për vetë specifikën që ka ky proces, do të organizohet në mënyrë individuale
-Vendi i zhvillimit të provimit do të jetë Klasa e filmit nr.1 Regji me sip. Rreth 40 m².

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NË SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE MESUESI

VITI I PARË

- Grupi i studenteve është 6 (gjashtë).
- Janë 4 lende që zhvillon viti i parë –master.
- 2 lënda janë detyrim dhe do të mbrohen nga studentet ditën e fundit të procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi i lëndës speciale Skenografi do të zhvillohet në mënyrë individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².
- Provimi i lëndës speciale Kostumografi do të zhvillohet në mënyrë individuale duke ruajtur distancimin social.
-Vendi i zhvillimit të provimit Atelier i skenografisë me sip. rreth 120 m².

Programi i studimit:

MASTER I ARTEVE NE KOREOGRAFI DHE MESUESI

VITI I PARË

- Grupi i studenteve eshte 10 (dhjetë).
- Jane 7 lende qe zhvillon viti i parë -master.
- Janë 6 lëndë detyrim dhe do te mbrohen nga studentet ditën e fundit te procesit mesimor apo konsultimeve.
- Provimi lendes speciale Koreografi do te zhvillohet ne menyre individuale dhe në grup deri në 2 studentë.

Për gjithçka parashtruar më sipër do të organizohet edhe orari përkatës me konsultime dhe mesim në auditor.

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skenografi –Koreografi,
Përgjegjësi i Njesisë Bazë Aktrim –Teori Arti,
Përgjegjësi i Njesisë Bazë Regji – Regji Filmi & TV,
Zv/Dekani i FAS

Prof. Ilir MARTINI

Prof.Asoc.Dr.Elida RAPTI

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Gazmend Gjoka

DEKANI

Prof. Petrit MALAJ

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

